



UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE

Adresa: Rruga e "Elbasanit", ndërtesa e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, kati i parë, Tiranë.

Lënda: Për kriteret e pranimit në programet e studimit të IAL-ve për vitin akademik 2023-2024

Drejtuar: REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS
Z. Artan Hoxha .

A. Kriteri bazë i përzgjedhjes për shpalljen e fituesve:

- Mesatarja e përgjithshme e studimeve Bachelor ose atij 4 vjeçar të jetë 6 e lart

B. Politika e përzgjedhjes bazohet në përparësitë e mëposhtme:

Së pari: përparësi kanë aplikantët e diplomuar në Fakultet e Universitetit të Tiranës:

- a. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë
- b. Fakulteti i Drejtësisë
- c. Fakulteti i Ekonomisë
- d. Fakulteti i Shkencave Sociale
- e. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Aplikantët e diplomuar në Universitet e Huaja sipas fakulteteve të më sipërme

Aplikantët e diplomuar në Universitet Private, të akredituar, me të njëtin profil.

C. Kush mund të aplikojë?

Për Mastër i Shkencave në drejtimin:

- **Legjislacion dhe Institucione në BE**

- Përparësi kanë aplikantët që kanë mbaruar studimet universitare në Fakultetin e Drejtësisë, UT të cilët kanë të paktën një diplomë Bachelor ose 4 vjeçar, si edhe aplikantë që vijnë nga fakultete të tjera publike dhe jo publike me të njëtin profil, të huaja ose vendase pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit dhe VKM në fuqi.

- **Politika dhe Qeverisja në Evropë**

- Përparësi kanë aplikantët që kanë mbaruar studimet Bachelor ose 4 vjeçar në UT në Fakultet e sipërcituara të UT (sipas pikës B), në Shkencat Sociale, Shkencat Politike, Drejtësi, Ekonomik, apo në fakultete të tjera publike dhe jo publike, të huaja ose vendase pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit dhe VKM në fuqi.

- **Diplomaci dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare të BE**

- Përparësi kanë studentët që kanë mbaruar studimet universitare në Fakultetet e sipërcituara të UT, që kanë të paktën një diplomë Bachelor ose 4 vjeçar apo në fakultete të tjera publike dhe jo publike, të huaja ose vendase pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores së fakultetit dhe VKM në fuqi.

Renditja e aplikantëve do të bëhet sipas kriterëve të mësipërme duke mbajtur parasysh mesataren zbritëse nga më e larta tek më e ulta.

Kandidati nuk mund të ndjekë një kohësisht dy programe studimi IAL

Në zbatim të Udhëzimit nr. 18. Dt. 16.08. 2017 kreu IV, pika 9, në momentin e përcaktimit të datave për regjistrim në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në ISE, kandidatët aplikantë do të paraqesin në sekretarinë e ISE-së dokumentacionin e mëposhtëm:

- Diplomën ose fotokopjen e saj të njehsuar me origjinalin të ciklit të parë të studimeve të përfunduara brenda ose jashtë vendit.
- Diplomën e Maturës shtetore së bashku me çertifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njehsuar me origjinalin, konfirmuar nga njësi përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para hyrjes në fuqi të vendimit për krijimin e maturës shtetore, paraqesin Deftesën e Pjekurisë, origjinalin ose fotokopjen e saj, të njehsuar me origjinalin dhe të konfirmuar nga njësi përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA).
- Dëshmi të gjuhës së huaj sipas informacionit të publikuar në faqen zyrtare të MASR www.arsimi.gov.al.
- Formularin e aplikimit i cili do të merret në sekretarinë e ISE-së
- Fotokopje të dokumentit të identifikimit
- Dy fotografi personale.
- Curriculum Vitae
- Deklarat për verifikimin e dokumentacionit shkollor me të cilën do të njihen nga sekretaria e ISE-së.

Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

Dëshmi të njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin

Drejtor
Prof.Dr. Aljula Jubani